

## STATUT I SHOQERISE

### “CENKO CO 2020 ” sh.p.k,

Në përputhje me ligjin nr. Nr.9901, datë 14.4.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqeritë Tregtare”, Ligji Nr. 131/2015 . PËR QENDRËN KOMBËTARE TË BIZNESIT”

#### KREU I

Neni 1

Emertimi

Shoqeria do të emertohet “**CENKO CO 2020**” sh.p.k, dhe është person juridik i të drejtës shqiptare.

#### Neni 2

#### Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria “**CENKO CO 2020** ” sh.p.k, është një shoqëri tregtare, e themeluar e themeluar nga ortaku i vetem:

- **Sajmir CENKO** me atesi Astrit dhe amesi Ruzhdie , i datëlindjes **09-09-1992**, lindur ne Luar , ALB dhe banues ne Roskovec,Luar; Nd. 189; H. 0; Ap. 0; Kuman; Luar; 9315; Roskovec , zotërues i letërnjoftimit me Nr.034677930.serie dhe me ID Nr.J20909010V.
- **Fitim SINJARI** me atesi Sabri dhe amesi Shegë , i datëlindjes **31-10-1981** lindur në , Donofrosë A.L.B dhe banues në Ura Vajgurore,Sinjari; Nd. 314; ; ; Cukalat; Donofrosë; 5018; Bashkia , Ura Vajgurore, zotërues i letërnjoftimit me Nr.BD8156604 dhe me ID Nr.I11031001N..

Të cilët përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë në mënyrë solidare humbjet e shoqërisë me nga 100 % pjesë të kontributit të derdhur prej seçilit . Kontributi i i ortakëve që përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Neni 3

Selia

**Shoqeria e ka selinë në luar , objekti i ndodhur në Zonën Kadastrale Nr.2497, Pasuria me Nr.50/15. , Vol.8, Faqe .69. , Luar rruga nationale Fier Roskovec.**

Shoqeria mund të ndryshoje selinë e saj, te hape zyra përfaqësie, dege, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqiperisë, vetëm me vendim të ortakut të vetëm.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

Transport rrugorë i mallrave brenda dhe jashtë vendit

-2- Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do të zhvilloje aktivitetin e saj për një periudhe kohore të papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

## KREU II

### KAPITALI

#### Neni 6

##### Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerisë është 100,000 ( njëqind mijë ) LEK , i ndarë në 2 pjesë në vlerë nga 50 000(pesëdhjetë mijë ) Lek . Ky kapital do të ngurtesohet pasi shoqeria të jetë regjistruar në QKB

Kapitali i mesiperm është nënshkruar nga ortakët e shoqërisë :

- **Sajmir CENKO** me atesi Astrit dhe amesi Ruzhdie , i datëlindjes **09-09-1992**, lindur ne Luar , ALB dhe banues ne Roskovec,Luar; Nd. 189; H. 0; Ap. 0; Kuman; Luar; 9315; Roskovec , zotërues i letërnjoftimit me Nr.034677930.serie dhe me **ID Nr.J20909010V**.
  - **Fitim SINJARI** me atesi Sabri dhe amesi Shegë , i datëlindjes **31-10-1981**, lindur në , Donofrosë A.L.B dhe banues në Ura Vajgurore,Sinjari; Nd. 314; ; ; Cukalat; Donofrosë; 5018; Bashkia , Ura Vajgurore, zotërues i pasaportës me **Nr.BD8156604** dhe me **ID Nr.I11031001N**.
- që përfaqësojnë secili nga 50 % te kapitalit themeltar të shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejtë). Kapitali do të paguhet në bankë menjëherë pas regjistrimit të Shoqerisë në Qendrën Kombetare te Biznesit .

Ortakët përgjigjen në mënyrë solidare për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve në masën të 100 % të kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë;

#### Neni 7

##### Zmadhimi dhe zvogelimi I kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe ne sherbime, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre sipas kërkesës së administratorit.

Zvogelimi i kapitalit realizohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit. Projekti i zvogelimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, në rast se ka të tillë, të paktën 45 ditë përpara datës së mbledhjes së ortakeve të thirrur për të marrë vendim rrëth këtij projekti.


Zvogelimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 6 te ketij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale. Në rast moszbatimi të kérkesave të këtij paragarfi, çdo personi interesuar mund të kérkojë në rrugë gjyqësore prishjen e shoqërisë. Kjo prishje nuk mund të shpallet, në qoftë se rregullimi është bërë në ditën kur gjykata mblidhet për të marrë vendim.

#### Neni 8

##### Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.



Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

**KREU III**  
**ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

*Neni 9*

*Organji Vendimmarres*

Asambleja e Pergjithshme eshte organi vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

*Asambleja e Pergjithshme, vendos për çështje si :*

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Pergjithshme regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejtë në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

*Neni 10*

*Administrimi*

Administrator i shoqerise "**CENKO CO 2020**" sh.p.k, është zoti Sajmir CENKO me nr. Kontakti : **+3550692312557**, emeruar në këtë detyre per një afat 5 vjear me te drejte riperteritje, duke filluar prej **17 – Shtator 2020** deri në **17- Shtator 2025**.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te ortakut te vetem te shoqerise.

*Neni 11*

*Kompetencat*

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqérinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për

Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojë përpëra asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare; Administratori eshte i detyruar të thërrasi mbledhjen e Asamblese se Përgjithshme edhe ne rastet kur sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpëra të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetet shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrëthanat me përashtim të kompetencave që ligji i jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrëthanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12  
Pergjegjesite

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrëthanat ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mëdus;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpërblyejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblyejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Për Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Neni 13  
Viti Financiar

Viti finansiar i Shoqërisë fillon me 1-Janar dhe perfundon me 31- Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finansiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

Neni 14  
Bilanci i shoqerise dhe dividentet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vtit finansiar, Asambleja e Pergjithshme , miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e ortakeve vendos rreth shperndarjes se dividentit, pasi te jene zbritur humbjet e vtit te meparshem finansiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15  
Eksperet

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar perqatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit finansiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakevet per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka. EKSPERT KONTABEL ( KONTABEL I MIRATUAR ) i shoqërisë do te zgjidhet gjate ecurise se shoqrrise ,

Neni 16

Të ardhurat neto ( Dividenti ) qe mbeten pas vecimit të fondevi ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbeten dhe i kalojne ne pronesi, ortakeve të shoqerise.

Neni 17

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Pergjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë per qendren kombetare te biznesit
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".


Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Asambleja e Pergjithshme.

Nëse Asambleja nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, cdo person i interesuar mund t'i drejtobet gjykates, për të caktuar një likuidues.

Neni 18

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij. Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përvçe kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të



posaçme.

Kufizimet e tagfave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likuiduesi u nënshtronhet mbikëqyrjes së Asamblese dhe administratorit.

Neni 19

Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.

3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ”, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga Asambleja e Pergjithshme, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

Neni 20

Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetur, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”

Neni 21

Bashkimi

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njërsë ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.
2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

Neni 22

Ndarja

1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të ortakeve, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërise ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.

2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 date 14.04.2008.

3. Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.

4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë: kalimin te shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëni ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta;

bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërise pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes; vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Biznesit pa kryerjen e likuidimit.

Neni 23  
Shnderrimi

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit te saj në shoqëri aksionare

Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

Neni 24  
Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 25  
Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 26  
Dispozita perfundimtare

Ky Statut u redaktua ne 4 ekzemplare me vlera te njejtë juridike ne gjuhen shqipe, dhe pasi iu lexua ortakeve, nenshkruhet me vullnetin e tyre te lire nga ortaket themelues.

ORTAKET THEMELUES:

1. Sajmir CENKO

Sajmir Cenko 

2. Fitim SINJARI

FITIM SINJARI 

Republika e Shqipërisë  
Ministria e Drejtësisë  
Dhoma Kombëtare e Noterëve  
Dhoma Lokale e Noterisë Vlorë  
Zyra e Noterisë Ballsh  
Noter Agron.Sh.HASANBASHAJ  
Adresa: Lagja "Shkurti" Ballsh  
Tel:0692925980



*608*  
Nr. Rep.

### VËRTETIM NËNSHKRIMI PËR STATUTIN

Sot në Ballsh , në datë.17—Shtator - 2020 (dymijë e njëzet ) para meje noterit publik Agron .Sh.. hasanbashaj , me zyrë në lagjen” 5 Shkurti” Ballsh , Bashkia Mallakastër, u paraqit personalisht shtetasi i mëposhtëm :

- **Sajmir CENKO** me atesi Astrit dhe amesi Ruzhdie , i datëlindjes **09-09-1992** ,lindur ne Luar , ALB dhe banues ne Roskovec,Luar; Nd. 189; H. 0; Ap. 0; Kuman; Luar; 9315; Roskovec , zotërues i letërnjoftimit me Nr.034677930.serie dhe me ID Nr.J20909010V.
- **Fitim SINJARI** me atesi Sabri dhe amesi Shegë , i datëlindjes **31-10-1981** lindur në , Donofrosë A.L.B dhe banues në Ura Vajgurore,Sinjari; Nd. 314; ; ; Cukalat; Donofrosë; 5018; Bashkia , Ura Vajgurore, zotërues i letërnjoftimit me Nr.BD8156604 dhe me ID NrI11031001N..

Në cilësinë e ortakëve të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ““CENKO CO 2020 ” sh.p.k, të cilët me vullnet të lirë dhe dëshirë të plotë nënshkroi këtë “ STATUT” pasi ka rënë dakort që ta njohë si statutin e tij.

Ky akt themelimi nenshkruhet prej ortakeve themelues ne datë. 17 - Shtator 2020

Unë noteri me përgjegjësi ligjore e nënshkruaj atë në bazë të ligjit 110/2018 datë.20.12.2018  
“Për Noterine” .

**NOTER**  
**Agron.Sh. HASANBASHAJ**